

V E N D I M
Nr.395, datë 24.6.1998

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.235,
DATË 10.4.1998 “PËR MIRATIMIN E PESË MARRËVESHJEVE HIDROKARBURE
TË RAUNDIT TË DYTË TË KËRKIMIT TË NAFTËS DHE GAZIT NË TOKË”**

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.235, datë 10.4.1998 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 fjalët “ONSHORE-2” ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “ONSHORE - 3”.

2. Në pikën 3 fjalët “ONSHORE-2” ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “ONSHORE - A”.

3. Paragrafi i fundit ndryshohet si vijon:

“Ky vendim hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ligjit nr.8297, datë 4.3.1998 “Për një ndryshim në ligjin nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)””, ndryshuar me ligjin nr.7853, datë 27.7.1994 “Për disa shtesa në ligjin nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”” .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano